



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

Nr. 5027 Prot.

Tiranë, më 08.08. 2022

**TERMAT E REFERENCËS
PËR “APLIKIM SI ANËTAR EKSPERT NGA
SHOQËRIA CIVILE NË KOMISIONIN E VLERËSIMIT TË
PROJEKTPROPOZIMEVE TË KANDIDATËVE PËR FONDET GRANT PËR
RININË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Vendimit nr.566, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”,

Në zbatim të Ligjit Nr. 75/2019 “Për Rininë” dhe vendimit nr.566, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët shpall thirrjen për aplikim si anëtar ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve.

Qëllimi:

Pjesëmarrja në Komisionin e Vlerësimit e (dy) anëtarëve ekspert nga shoqëria civile për shqyrtimin dhe vlerësimin e projektpropozimeve të përgatitura nga organizatat rinore, organizatat për të rinjtë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kandidatëve në thirrjet konkurruese të shpallura nga Agjencia Kombëtare e Rinisë për vitin 2022.

Në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit “Për mbështetjen e sektorit të rinisë” nënshkruar midis Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Drejtorit të Programit për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri në Mars 2022, UNDP Albania përmes Programit rajonal për demokracinë vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD 2) mbështet MSHRF dhe AKR-në në zbatimin e metodologjisë LOD duke siguruar ekspertizë teknike në procesin e përzgjedhjes dhe kontraktimin e (dy) anëtarëve ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve, duke rritur nivelin e transparencës, pjesëmarrjes dhe besueshmërinë e procesit.

Procesi i përzgjedhjes së aplikanteve:

Përzgjedhja e anëtarëve ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve do të bazohet në një proces të hapur konkurrimi dhe zhvillohet në dy faza:

Në fazën e parë, UNDP Albania do të zhvilloj procesin e vlerësimit të aplikimeve mbi bazë të vlerësimit të kriterëve teknike (70%) dhe propozimit financiar (30%) të aplikantëve.

Në fazën e dytë, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët do përzgjedhë dy anëtarët ekspert dhe dy anëtarët rezervë, në rast krijimi të vakancës, nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve.

Kriteret e aplikimit:

Anëtari ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve, duhet të plotësojë kushtet mëposhtme:

- Të ketë mbaruar studimet universitare “master” për drejtësi, administrim publik, shkenca ekonomike apo shkenca shoqërore;
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Të ketë mbi 10 (dhjetë) vjet përvojë pune;
- Të ketë përvojë të mëparshme në vlerësimin e projektpropozimeve të organizatave të shoqërisë civile në thirrje konkurruese për financim;
- Të ketë përvojë në përgatitjen, zbatimin, monitorimin dhe/ose vlerësimin e projektpropozimeve të financuara me fonde publike;
- Të ketë njohuri në fushën e politikave dhe çështjeve rinore;

Procesi i aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të ndjekin procedurat e aplikimit në faqen e internetit, si vijon:

https://jobs.undp.org/cj_view_job.cfm?cur_job_id=108934

Afati i aplikimit:

Afati përfundimtar i dorëzimit të aplikimit është data 16 shtator 2022.

Periudha e zbatimit të detyrave:

Shtator – Tetor 2022

Informacion shtesë:

Dy anëtarët ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve do të kontraktohen dhe paguhen nga UNDP Albania.

MINISTËR

BORA MUZHAQI

